

**LINGUISTIC PHENOMENA CREATED BY THE INTERNET AND
SOCIAL NETWORKS**
**DUKURITË GJUHËSORE QË I KRIJOI INTERNETI DHE RRJETET
SOCIALE**

Ajten HAJDARI-QAMILI¹, Vildane ISMANI²

¹ Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University „Ss. Cyril and Methodius“ - Skopje

² Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University „Ss. Cyril and Methodius“ - Skopje

*Corresponding author e-mail: ajten.hajdari@ukim.edu.mk

Abstract

We live in a digital age where everyone is dependent on the internet and social networks. Being constantly in direct and daily contact with the written language through social networks and various websites, its influence on our spoken and written language is inevitable. From the many analyzes and researches that have been done regarding the impact of the Internet on many world languages, different linguistic phenomena have been highlighted. Some of the phenomena are general and have penetrated almost all languages of the world, while some are specific to specific languages. Of course, some typical phenomena from the Internet have been created in the Albanian language, starting from the general ones, such as: abbreviations FLM, KLM, vër8, t h z, fmljn (= family - writing without vowels) etc.; anglicisms whether abbreviations, words or whole sentences); then: not using Le] and LS, interweaving dialectal words within the same text or using dialectal features that distinguish Gege from Tosk and vice versa; the creation of Internet jargon and many other phenomena. All these phenomena will be treated in this statement, classifying them into groups, trying to find the reasons why these phenomena appeared and their evolution. In the end, we will give our assessment of whether these phenomena are harmful or beneficial for Albanian, where this "path" that we have started takes us and what measures we should take to avoid negative phenomena.

Keywords: *internet, language, phenomenon, classification, causes, impact, solutions.*

Abstrakti:

Jetojmë në një epokë digjitale ku secili njeri është i varur nga interneti dhe rrjetet sociale. Duke qenë vazhdimisht në ballafaqim të drejtpërdrejtë e të përditshëm me gjuhën e shkruar nëpër rrjetet sociale dhe uebfaqe të ndryshme, është i pashmangshëm ndikimi i saj në gjuhën tonë të folur dhe të shkruar. Nga shumë analiza dhe hulumtime që janë bërë lidhur me ndikimin e internetit në shumë gjuhë botërore, janë vënë në pah dukuri të ndryshme gjuhësore. Disa nga dukuritë janë të përgjithshme dhe kanë depërtuar pothuajse në të gjitha gjuhët e botës, kurse disa janë të veçanta për gjuhë të veçanta. Natyrisht, se edhe në gjuhën shqipe janë krijuar disa dukuri tipike nga interneti, duke filluar nga ato të përgjithshmet, si: shkurtesat FLM, KLM, vër8, t h z, fmljn (= familjen - të shkruarit pa zanore) etj.; anglicizmat (qofshin shkurtesa, fjalë apo fjali të tëra); pastaj: mospërdorimi i [ë]-së dhe [ç]-së, gërshetimi i të folmeve dialektore brenda të njëjtit tekst ose përdorimi i veçorive dalluese dialektore gege nga toskët dhe anasjelltas; krijimi i zhargonit të internetit e shumë dukuri të tjera. Të gjitha këto dukuri do të trajtohen në këtë kumtesë, duke i klasifikuar në grupe, duke u përpjekur të gjejmë shkaqet pse janë paraqitur këto dukuri dhe evoluimin e tyre. Në fund do të japim vlerësimin tonë se a janë këto dukuri të dëmshme apo të dobishme për shqipen, ku na çon kjo "rrugë" që kemi nisur dhe çfarë masash duhet të ndërmarrim që të shmangim dukuritë negative.

Fjalët çelës: *interneti, gjuha, dukuri, klasifikim, shkaqe, ndikim, zgjidhje.*

Kohëve të fundit është bërë modë që të përdoren shumë shkurtesa gjatë të shkruarit nëpër rrjetet sociale, me qëllim të ekonomizimit të gjuhës (*flm, sps, ntm, thz, ...*). Nëse shikohet nga ky këndvështrim na vjen më lehtë, sepse kursejmë hapësirë, kohë, më pak i lodhim gishtat, por nëse shohim nga këndvështrimi gjuhësor dhe pasojat që mund të lënë te brezat e ardhshëm do ta kuptojmë se sa shumë dëm po i bëjmë gjuhës shqipe. Së pari cungojmë dhe gjymtojmë vetë fjalët e shqipes duke krijuar secili shkurtesa të veta që pastaj marrin hov dhe përhapen shumë shpejt kudo, pastaj përdorim edhe shumë shkurtesa të huaja si *OK, thnx, pls* e shumë të tjera, të cilat me kalimin e kohës mund të krijojnë një gjuhë amalgamë.

Teknologjia e bën të vetën, njerëzit e sotëm janë gjithmonë në vrap pas diçkaje, shpesh pas gjërave pa vlerë, gjithmonë u mungon koha dhe fatkeqësisht asnjë punë nuk e bëjnë me përkushtim maksimal dhe me përgjegjësinë e duhur. E kur bëhet fjalë për kujdesin dhe kultivimin e gjuhën amtare, ajo u duket diçka shumë e parëndësishme. Ndërkohë që harrojnë se gjuha është ajo që krijon dhe identifikon një komb. Ne, falë gjuhës shqipe sot quhemi shqiptarë, gjuhë kjo që ka rezistuar plot sfida gjatë mijëra viteve, prandaj është mëkat i madh që sot nga përtacia dhe papërgjegjësia jonë të shembin një kullë që na e kanë ndërtuar të parët tanë. Për këtë arsye, lusim çdo shqiptar që të kujdeset për shqipen ashtu siç kujdeset për sytë e vet.

Njerëzit e sotëm gjithë ditën rrinë me telefon në dorë dhe komunikimet i zhvillojnë përmes rrjeteve sociale si Instagram-i, Tiktok-u, Snapchat-i, Facebook-u, Viber-i, WhatsApp-i dhe rrjeteve të tjera sociale, edhe nëse personat me të cilët komunikojnë përmes rrjeteve sociale mund të jenë shumë afër njëri-tjetrit, madje edhe brenda shtëpisë. Kjo është përditshmëria e njerëzve në kohën e internetit dhe rrjeteve sociale ku e gjithë bota është e disponueshme me një klikim. Përdorimi i përditshëm i rrjeteve sociale ka ndikuar edhe në fjalorin e përdoruesve. Rrjetet sociale kanë krijuar disa dukuri gjuhësore disa globale e disa të veçanta, siç janë shkurtesat e huaja si *IDK* (I don't know – nuk e di), *like, thanks, flm, thz, sps* dhe shumë fjalë e shkurtesa të tjera.

Nga ekspertët e mediave sociale dhe sociologëve, varësia nga rrjetet sociale dhe dukuritë gjuhësore e jashtëgjuhësore që po na shfaqen kohëve të fundit, shihet si një përplasje mes dy gjeneratave apo dy botave të ndryshme, si në shkollë nxënësit me mësimdhënësit, ashtu edhe në shtëpi fëmijët me prindërit. Sipas tyre, të gjithë gjërat që ofron stili i jetës moderne në internet nuk duhet të refuzohen, veçanërisht nëse ato janë të dobishme në zgjerimin e njohurive dhe që mund të ndihmojnë në procesin mësimor. Megjithatë, duhet pasur kujdes në efektet negative që mund të japin rrjetet sociale.

Dukuritë gjuhësore që i krijuan përdoruesit e rrjeteve sociale në mënyrë që të ndërveprojnë midis tyre dhe të përcjellin përjetime të ndryshme emocionale, janë: shkurtimi i fjalëve, përdorimi i anglicizmave, përsëritja e shenjave të pikësimit; përsëritja e fjalëve, e zanoreve ose e bashkëtingëlloreve; zëvendësimi i fjalëve ose një pjese të fjalës me simbole të ndryshme ose numra; shkronjat e mëdha në mes të fjalisë ose në të gjithë fjalinë, pasthirrmat e ndryshme, emotikone etj.

Cungimi i fjalëve - Shkurtime

Dukuria e emërtimeve të shkurtuara (*shkurtime, shkurtesat ose akronimet*) nuk është një proces i ri që lidhet me gjuhën e internetit në ditët e sotme, por ato janë përdorur në gjuhë prej kohësh dhe janë trajtuar si një mënyrë fjalëformimi, ndonëse më pak prodhimtare.¹⁸ Megjithkëtë, komunikimi përmes rrjeteve sociale e rriti numrin dhe dendurinë e përdorimit të tyre.

¹⁸ <https://www.portalishkollor.al/news/shqipja-e-perdorur-ne-rrjete-sociale-rasti-i-facebook-ut>

Përveç shkurtimeve tradicionale që janë të larmishme dhe që ndeshen gjerësisht në tekste të ndryshme, si: cm (centimetër), d.m.th. (domethënë), etj. (e të tjera) etj. në postime dhe në komente bashkëbiseduesit përdorin shumë shkurtime të reja duke i reduktuar fjalët në fillim, në mes ose në fund të tyre, por shumë më e përhapur është metoda e largimit të të gjitha zanoreve përbërëse dhe pavarësisht kësaj ato mbeten të kuptueshme nga bashkëbiseduesi. Është e vështirë të jepet lista e plotë e shkurtimeve të tilla, por që më poshtë jemi munduar t'i rendisim ato që i ndeshim më shpesh:

1. Shkurtesa me heqjen e zanoreve: *dtl* = ditëlindje, *dtm* = ditën e mirë, *fb* = facebook, *fix* = fiksoj, *flm* = falemnderit, *gr* = grupi, *gz* = gëzohem, *klm* = kalofsh mirë, *mbr* = mirëmbërëma, *mrz* – mërziur, *nrm* = normal, *ntm* – natëm e mirë, *mszh* – mesazh, *pc* = kompjuter, *plq* = pëlqej, *prsh* = përshëndtje, *pz* = për zotin, *sps* = s'ka përse, *srz* = seriozisht, *thz* = ta ha zemrën, *zmr* = zemër etj.

Për shprehjen e urimeve ose ndjenjave të ndryshme përdoren vetëm shkronjat e para dhe tashmë shkurtesa të tilla si, *tdsh*, *tkshxh*, *tkz*, *klb*, *klm* janë bërë klishe dhe gjenden kudo nëpër biseda të ndryshme. Pavarësisht se i takojnë gjuhës së shkruar, ndonjë prej këtyre shkurtesave është bërë pjesë e komunikimit të përditshëm, jashtë kufijve virtualë nga të rinjtë, por jo vetëm (*klb*, *klm*, *flm*).¹⁹

2. Kur flasim për shkurtime të fjalëve, mjaft prezente janë edhe dukuritë fontetike, si sinkopa, apokopa dhe afereza. Ndaj këtu do të dallojmë këto shkurtime: a). Shkurtimi i fjalëve përmes sinkopës: *fmi* = fëmijë, *kshu* = kështu, *shpi* = shtëpi etj. Nga teatri drejt në **shpi** dhe vazhdova me mësimin; b). Shkurtimi i fjalëve përmes apokopës: *erdh* = erdhi, *ish* = ishte, *kish* = kishte, *mo* = mos, *pi* = prej etj. (Pa mos **pritu erdh** dhe u kënaqëm). c). Shkurtimi i fjalëve përmes aferezës: *shti* – tashti, *shtir* = vështirë etj. (**Shti** është **shtir** t'i besojm gjithkujt).

3. Shkurtimi i mbiemrave (patronimeve) - Në mesin e të rinjve është shumë interesante përdorimi i emërtimeve të profileve të tyre në facebook, në instagram, por edhe në rrjetet e tjera, përkatësisht shkurtime të mbiemrave të tyre në profil. Shembull: *Vebi Cani* (Hasani), *Drita Osm* (Osmani), *Lirim Slm* (Selmani) etj.

4. Shkurtimi i toponimeve - Ajo që shpesh bie në sy gjatë komunikimit online është edhe përdorimi i shkurtimeve të toponimeve (nga shkurtesat e përdorura në tabelat e veturave) kështu duke iu referuar vendbanimeve të ndryshme: *AL* = Shqipëri, *KS* = Kosovë, *KU* – Kumanovë, *PR* = Prishtinë, *SK* = Shkup, *TR* = Tiranë etj. *Dje ishim në KS dhe nga lodhja nuk munda të zgjohem. Për momentin jam në TR. Kur te kthehem do te thirri. Jam nga SK.*

5. Mosshkruarja e [ë]-së së patheksuar - Gjatë komunikimit në rrjetet sociale, vihet re mospërdorimi i ë-së, sidomos kur është në pozitë fundore, por edhe në trup të fjalës kur ajo është e patheksuar. P.sh.: *djal* = djalë, *gjat* = gjatë, *jet* = jetë, *mir* = mirë, *pun* = punë, *shkoll* = shkollë, *shum* = shumë, *zan* = zanë etj. *Me jet të gjat. U gëzova që ke djal.*

Përdorimi i fjalëve, shprehjeve, pasthirmave dhe shkurtesave nga anglishtja

Dominimi i anglishtes është i pranuar botërisht. Ndikimi i saj ka prekur thuajse çdo gjuhë pa mos e lënë anash as shqipen. Është shqetësuese ndërfutja e fjalëve, shprehjeve, shkurtesave apo pasthirmave nga anglishtja pa nevojë, por shumë njerëz i përdorin këto anglicizma gjoja për të treguar modernizëm apo kulturë bashkëkohore. Anglicizmat më shpesh që përdoren në komunikimin e rrjeteve sociale janë: *downllaud* (shkarko), *ëkaunt* (llogari) *çek in* (vendndodhje), *ed* (shto), *follder* (dosje), *followersa* (ndjekës), *follou* (ndiq), *frends* (miq), *full* (i/e stërmbushur), *invajt* (fto), *llajk* (pëlqej), *memori* (kujtesë), *story* (ngjarje), *share* (shpërndaj), *tag* (etiketo), *sissy* (motër), *bro* (vëlla), *mommy* (nënë), *hubby* (bashkëshort) etj. Këto fjalë ndonjëherë shkruhen ashtu siç shkruhen në anglisht (*download*, *account* etj.), por nga disa përdorues shkruhen ashtu siç lexohen.

¹⁹ <https://anxhelinalanga.wordpress.com/2017/02/15/deformimi-i-gjuhes-shqipe-ne-rrjetet-sociale/>

Ja edhe disa fjali konkrete: *Urime ditëlindjen Hubby! HBD zemra ime! RIP gjyshja ime. Wow dukesh për mrekulli. Yeah, e dija. Wuuuuu i erdhi momenti kësaj gjëje. A e shikove storyn tim? Ja kish bo like qasaj qikes. Qe tash po ta boj tag.*

Përdorimi i q-së në vend të ç-së dhe i e-së në vend të ë-së

Mjaft interesante është edhe ngatërimi i shkronjave të ndryshme, gjë që nuk e hasim vetëm në biseda interne në mes bashkëbiseduesve, por edhe në postime të ndryshme publike në internet. Përdorimi i q-së në vend të ç-së është si pasojë e tastierave që nuk e përmbajnë këtë shkronjë dhe përdoruesit duke mos e bërë ndërrimin e tastierës në gjuhën shqipe, si alternativë për ta zëvendësuar ç-në e shohin q-në dhe për ta zëvendësuar ë-në përdorin e-në. Megjithatë, njëkohësisht këtu kemi edhe ndikimin dialektor, që ka përgjithësisht gegërishtja (verilindore dhe qendrore), pra afrikatizimin e qiellzoreve. Për këtë shkak, folësit e këtyre trevave shpesh nuk e dallojnë q-në nga ç-ja.

P.sh.: *Qerdhja jone per femije nesor do te organizoje shfaqje. Qdo gatim u juaji eshte i mireseardhur! Qanten e bleva lir. Isha n'qajtore. Gjithqka ishte bukur. Sa esht qmimi i patikave?*

Përsëritja e shenjave të pikësimit

Shenjat e ndryshme të pikësimit, përdoren jo vetëm si shenja gramatikore për ndarjen e fjalive ose pjesëve të një fjalie, por rregullat e përdorimit të tyre janë modifikuar nga përdoruesit për të realizuar nevojat e tyre gjatë komunikimit. Me anë të përsëritjes së shenjave të pikësimit, bashkëbiseduesit arrijnë të shprehin elemente të ndryshme prozodike si një mënyrë për të kompensuar mungesën e gjesteve të fytyrës, gjuhën e trupit dhe rrethana të tjera kontekstuale të hasura zakonisht në një bisedë ballë për ballë.

Kur biseda bëhet e pakuptueshme ose kur personi nuk përgjigjet apo vonon përgjigjen, bashkëbiseduesi, në vend të pyetjes me fjalë, zgjedh të vendosë disa pikëpyetje rresht:

??????????

A kaq pak veta ishit????

ku je???

hejj??????????

qka??????

Pikëçuditja përsëritet në rastet e urimeve për të shprehur ndjenjën e kënaqësisë, për të shprehur habi, për të përforcuar mendimin, por edhe për të shfaqur zhgënjimin ose pakënaqësinë:

Mazallah !!! Larg qoftë!!!

Të pershendes !!!!!!!!

Kshtu paskam then a????!!!!!!!

Mjerim!!!!

Katastrof!!!!

Khaaaa!!!!!!

Pika në formë të përsëritur, përdoret për të treguar se përmbajtja e mesazhit vazhdon më tej ose nuk është e lehtë për t'u shprehur diçka:

Sa keq... zdi si përfundoi gjithqka... më vjen t'i them...

Sot tan ditën lava, fshiva, pastrova, bona buken.....

Zanore ose bashkëtingëllore të përsëritura

Një tjetër strategji për të shprehur gjendjet e ndryshme emocionale nga përdoruesit e rrjeteve sociale është përsëritja e zanoreve ose bashkëtingëlloreve për përforcimin e ngarkesës emocionale të fjalëve e për të shprehur qëndrimet emocionale si lumturinë, gëzimin, zhgënjimin, mërztijen etj., si p.sh.:

Hahahhahaahaha sa interesante.

Ahhhh bre shpirt.

Saaaa mirë, dua të jem me ty.

Te thashhhhh të ikje me kohë.

Te dua shuuuuuum

Jam merzit shummmmm

Vetem tiiiiiii e di

Saaa bukurrr

Rrooofsh e daaaaashur.

Eeeee a te thash?

Përdoruesit e rrjeteve sociale përzgjedhin në mënyrë rastësore zanoren që përsërisin pa e menduar nëse kjo është zanorja e theksuar, gjithashtu përveç bashkëtingëllores së parë, përsërisin edhe bashkëtingëllore në pozicione të tjera të fjalës në mënyrë krejt rastësore, p.sh.:

Sa të shishhhhhme qenkan bërë mojjjj!!!

Më nnnnneveritt egoja e saj.

Për nga shpeshësia, më shumë përsëriten zanoret, sesa bashkëtingëlloret, sidomos në llojet e ndryshme të përsëritjeve, urimeve dhe falënderimeve, si p.sh.:

Te peershendes për jetë e mot...

Shuumë urime për tyyyyy!

Kaaaam ardhur.

Rrooofsh për jetë!

Formulimet numër ose simbol + shkronja

Në gjuhën e përdorur në internet shpesh shohim fjalë të ndërtuara nga një numër e disa shkronja dhe shqiptimi i tyre përkon me kuptimin e asaj fjale. Siç mund të jenë fjalët: *mjesh3* = mjeshtrë, *5imist* = pesimist, *për7tatemi* = përshtatemi, *3gon* = tregon, *i 3nt* = i trent, *vër8* = vërtet, *me1herë* = menjëherë, *18er* (= later 'më vonë'), *b4* (before 'para'), *as1herë* = asnjëherë, & = dhe, *aktivi8* = aktivitet, *fytyr@* = fytyrat etj.

Shoku përmbidhe veten, mos ji kaq 5imist.

3go çfarë paska ndodhur?

Nga biseda shihej që ishte shumë i 3nt.

Shkronjat e mëdha

Përdorimi i disa fjalëve me shkronja të mëdha ose ndonjëherë i gjithë mesazhi është një zgjedhje e bashkëbiseduesve për të vënë në pah atë që duan të theksojnë më tepër dhe për të rritur gjendje emocionale të tilla si gëzim, kënaqësi, neveri, frikë etj.

Fotografia të ngjallte EMOCIONE DASHURIE dhe DHEMBËSHURIE njëkohësisht. Sa hyjnore është lidhja në mes partnerëve të jetës!

Të dua SHUUMË!

Nga historia e dëgjuar e kuptova domethënien e të qënit PRIND.

JETOFTË E MBRETËROFTË PËR JETË!

Ti je YLL!

Pasthirrma emocionale

Pasthirrat emocionale që shprehin ndijime, ndjenja apo vullnetin e folësit përdoren dendur në mesazhet nëpër rrjetet sociale. Pasthirrat jo të mirëfillta përdoren shpeshherë me tingujt të përsëritur (uffffff, shuuuuuumë, mirupafshiiiiim, kuuuuuu, phaaaa).

Hahahaah sa mendje hollë qenke mooooj.

Eeee gjë e dëgjuar tanimë.

Uau magjepsëse dukej me fustanin e kuq.

Bobo, ende pyet ky?

Pfff ta shpifte me gënjeshttrat.

Phuuu, si s'mu kujtua në atë moment.

Uffffff bre sa inat.

Ncncncnc si ben edhe ti, sikur te vrava.

Hmmmm ashtu është.

Phaaa sa inat me vjen bre!

Hihihihih sa mir ta bera!

Përdoren edhe disa pasthirra nga anglishtja, si p.sh.: **Wow** dukesh për mrekulli. **Yeah**, e dija. **Wuuuuu** i erdhi momenti kësaj gjëje etj.

Emotikona

Funksioni i emotikonave ose të quajtura ndryshe 'smileys' është mënjanimi i paqartësisë duke kombinuar shenja të ndryshme pikësimi me karaktere dhe shifra për të krijuar imazhe të fytyrës që shprehin ndjenja të larmishme si lumturi, trishtim, habi, frikë e shumë të tjera. Efekti i tyre është i menjëhershëm, sepse e shprehin qartë ndjesinë e bashkëbiseduesit, p.sh. nëse ai është i gëzuar, përdorimi i emotikonës e përcjell drejtpërdrejt gëzimin te tjetri. Disa emotikona që shprehin gëzim, frikë, zemërim kanë frekuencë përdorimi më të madhe, sesa emotikonat e tjera që janë të shumta në numër.



Përfundim

Është më se e rëndësishme të njihen dhe të trajtohen shkaqet që kanë sjellë dukuri të këtilla në gjuhën e komunikimit në rrjetet sociale. Ato mund të jenë nga më të ndryshmet, por që duhet pranuar se njerëzit duke qenë gjithnjë në nxitim, duke e pasur kohën të kufizuar, duan të arrijnë sa më shkurt e më shpejt te një qëllim i caktuar, në rastin tonë bartjen dhe marrjen e informacionit dhe ndjenjës. Në anën tjetër jemi të vetëdijshëm që kohëve të fundit i ka rënë pesha gjuhës, sidomos asaj amtare meqë atë njerëzit e shohin thjesht si mjet komunikimi dhe nuk e kalisin në aspektin stilistikor, drejtshkrimor e sintaksor. Ndryshe thënë duam që vetëm të merremi vesh në mes vete, pa mos mbajtur llogari se sa e dëmtojmë gjuhën në çdo aspekt.

Çdo dukuri duhet trajtuar në dy aspekte: duhet të shihen anët pozitive dhe negative të saj. Ana pozitive e dukurive të trajtuara më sipër mundësojnë që më shpejt të bartet informacioni, t'i kumtojmë mendimet tona dhe kështu ne tregohemi më ekonomikë në shfrytëzimin e kohës. Por, dëmet janë edhe më të fuqishme sesa këto përparësi, sepse kështu ne ecim drejt shkatërrimit të gjuhës, elementit themelor identifikues të kombit. Përdorim gjuhë pa asnjë lloj kriteri dhe pa standarde të paracaktuara, e cila çdo ditë e më shumë ndikon në zvogëlimin e numrit të zotëruesve të mirëfilltë të shqipes standarde. Pos prishjes së imazhit të vërtetë të gjuhës shqipe, në mes bashkëbiseduesve mund të lindin keqkuptime të ndryshme, sepse jo gjithsecili nga ne e zotëron këtë gjuhë “të koduar” që është krijuar sidomos nga brezi i ri.

Referencat:

Ajten Hajdari-Qamili, Cilat jane sfidat me te cilat ballafaqohet gjuha amtare, KOHA, 21.02.2014.
Ajten Hajdari-Qamili, Kujdes për shkronjat dhe gjuhën shqipe, Portalb, Shkup, 16:33 më 20.11.2016.
<http://portalb.mk/375268-dy-dekada-reformim-te-pasuksesshem-te-sistemit-arsimor-shqiptaret-mbeten-ne-vendnumero/>
<https://anxhelinalanga.wordpress.com/2017/02/15/deformimi-i-gjuhes-shqipe-ne-rrjetet-sociale/>
<https://sq.warbletoncouncil.org/abreviaturas-redes-sociales-1840>
<https://telegrafi.com/e-dini-se-cfare-te-thote-ngl-dhe-e-perdorni-si-duhet-kete-shkurtese/>
<https://wetransfer.com/downloads/fe785d938ab0f4350f0e11d04491e39520200312202901/87ff55564220805a7d0d5ac6a99760ce20200312202901/577a1d>
<https://www.facebook.com/289839541067084/posts/3040213716029639/>
<https://www.facebook.com/AlsatMTTelevision/videos/199068451440059/?vh=e>
<https://www.facebook.com/radiokosova1/videos/1125854260957605/UzpfSTY1MTg2NTI0NzoxMDE1NjQ4MzA3NzA0NTI0OA/>
<https://www.portalishkollor.al/news/shqipja-e-perdorur-ne-rrjete-sociale-rasti-i-facebook-ut>
<https://www.youtube.com/watch?v=W1SyyUpIhkM&feature=share>
<https://youtu.be/KYh2pRD3t7I>